



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 212/25

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Batisha Ibrahim - Kryetare, Kimete Gashi- Anëtare si dhe Vedat Poterqoi Anëtar, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Komuna Prizren me numër 212/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE MEB L.L.C – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Dezinsektimi, Deratizimi dhe Dezinfektimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të spitalit, me nr: të prokurimit: 70020-24-12035-2-2-1, iniciuar nga Komuna Prizren, më: 19.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Komuna Prizren, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE MEB L.L.C, me nr: unik 810975576 - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Sigurimi fizik i objekteve të shëndetësisë primare në Komunen e Prizrenit, me nr: të prokurimit: 622-24-8069-2-2-1, iniciuar nga Komuna Prizren.

II. **Diskualifikohet** nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje prej (6) muaj kalendarik, duke filluar nga data 19.06.2025 deri me datën 18.12.2025.

A R S Y E T I M

Kërkesa e AK- Komuna Prizren:

Autoriteti kontraktues pretendon se OE MEB L.L.C, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Sigurimi fizik i objekteve të shëndetësisë primare në Komunen e Prizrenit, me nr: të

prokurimit: 622-24-8069-2-2-1, ka mashtruar me deshmit e dorezuara me arsyetimin se gjate vleresimit te ofertave kemi bere verifikimin e nje fature me nr: 001/2020 te dates: 15.09.2020.

Autoriteti kontraktues, permes email-it, ka kerkuar sqarim me shkrim nga administrata taimore e Kosoves, e cila ne pergjigje per kete fature ka deklaruar se opertori ekonomik e ka bërë raportimin e kësaj fature me datë 07.02.2025 tek libri i blerjes mirëpo nuk është bërë tek deklarata e TVSH-së dhe sipas sqarimeve te ATK-së, përderisa fatura nuk është deklaruar edhe ne deklaratën e TVSH-së konsiderohet e pa deklaruar.

Mbi bazen e sqarimeve te dhena me larte, autoriteti kontraktues kerkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 te LPP-se me pretendimin se OE Meb L.L.C, ka paraqitur dokumente me permbajtje te rreme ose te falsifikuar.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 21.02.2025, te AK - Komuna Prizren, e ka njoftuar OE Meb L.L.C, me qellim qe operatori ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Meb L.L.C, në përgjigje te kërkesës se OSHP-se ka dhene faktet dhe argumentet e veta lidhur me pretendimet e AK-se.

Une si ish pronar i kompanise SFK SH.P.K me NUI:810973041 dhe ponjashtu ish pronar i kompanise MEB L.L.C me NUI:810975576,pra pronar i te dy kompanive,deshta te ju sqaroj per fakturen 001/2020 te dates 15.09.2020 .

Ne Shkurt te vitit 2020 kompania SFK SH.P.K ka pasur nje kontrrolle nga ana e ATK-se,dhe simbas tyre kan gjetur mangesi ne kompanine time dhe na kan gjobitur padrejtesishte.Une si pronar nuk jame pajtuar me vendimin e ATK-se dhe lenden ia kam drejtuar Gjykates Ekonomike.

Per shkak se lenda ka qene ne Gjykat dhe kemi qene njekohsishte te bllokuar nga ATK-ja ne nuk kemi mundur te bejme transakcione bankare qe do te thote se nuk kemi mundur ta fakturojm ne EDI sepse ka qene e pamundur por e kemi dorezuar ne ATK fakturen-001/2020 te dates 15.09.2020.

Faktura eshte e deklaruar pa TVSH.

Kjo ishte sa i perket kompanise SFK SH.P.K ,ponjashtu une kam qene pronar i kompanise MEB L.L.C e cila kishte nevojë per paisje sigurimi te cilat I posedonte kompania SFK SH.P.K per te qene me transparente eshte bere faktura e shit-blerjes ndermjet dy kompanive.

Kjo faktur ne kompanine MEB L.L.C eshte e deklaruar si facture e blerjese se paisjeve. Ne ATK eshte ne system.Ne kemi te korektojm cdo fakture e cila nuk eshte evidentuar per shkaqe te ndryshme .

Edhe ju KK I Prizrenit e keni mare pergjigjejen nga ATK-ja se faktura eshte e evidentuar. Kjo faktur nuk eshte fiktive,dhe per cdo parregullesi apo vonese ATK-ja eshte organi i cili i kontrollon fakturat dhe vendose.

Vlerësimi i pretendimeve të autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE "MEB L.L.C":

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së Autoritetit Kontraktues-Komuna e Prizrenit dhe arsyeshmërisë së dhënë ku AK në këtë rast ka aplikuar nenin 52.7 të LPP-së citon “ *Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.* ” dhe nga përgjigja e ofruar nga ATK-ja me kërkesën e AK-se që sipas të dhënave zyrtare nga Administrata e Kosovës se “ *fature me nr: 001/2020 të datës: 15.09.2020. Autoriteti kontraktues, përmes email-it, ka kërkuar sqarim me shkrim nga Administrata Tatimore e Kosovës, e cila në përgjigje për këtë faturë ka deklaruar se operatori ekonomik e ka bërë raportimin e kësaj fature me datë 07.02.2025* ” e që i bije deklarami i faturës pran ATK-së është bërë rreth 06 muajshë pas hapjes së ofertave (Hapja e ofertave 26.08.2024) ,ndërsa fatura e vitit 2020 pa u përfshirë TVSH-ja. Paneli Shqyrtues pas diskutimeve dhe shoshitjes së provave konstaton se autoriteti kontraktues – Komuna Prizren, ka dorëzuar provë që dëshmon se OE MEB L.L.C, në këtë aktivitet të prokurimit, ka mashtruar AK-ne ku ka ofruar faturë fiktive, për të cilën OSHP duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së , merr masa konkrete ndaj këtij Operatorit Ekonomik.

Paneli Shqyrtues duke analizuar përgjigjen e ofruar nga OE se si ish pronar i kompanis SFK SH.P.K me NUI : 810973041, ku sipas të dhënave në faqen zyrtare ky NUI del të jetë OE DARDAN EXPORT GROUP SH.P.K. me pronar: Raif Karadži, dhe poashtu ish pronar i kompanis MEB L.L.C me NUI : 810975576, Data e regjistrimit: 16/12/2016 me pronar: Uluaras Damka , ku në ofertën e dorëzuar për këtë aktivitet të prokurimit sipas Çertifikates së regjistrimit me të dhëna MEB L.L.C me NUI : 810975576 pronar Sylaitolu Damka.

Deklarimi lidhur me faturen nr. 001/2020, e datës 15.09.2020 për të cilën pretendohet se nuk është deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës, për arsyeje se lënda ka qenë në Gjykat dhe kemi qenë njekohesisht të bllokuar nga AKT-ja, dhe sipas tyre kanë gjetur mangësi në kompaninë e tyre dhe i kanë gjetur padrejtësisht, PSH ka analizuar faturën e kontestuar nga AK-ja dhe vërteton se në faturë janë dy NUI njëra në emër të biznesit MEB L.L.C me NUI : 810975576, ndërsa numri tjetër i figuruar NUI 811978131 ku sipas të dhënave ARBK-se figuron të jetë i “KLUBI I FUTBOLLIT LIRIA SH.P.K”. e që në rastin konkret përveq një përgjigje të ofruar pran OSHP-se OE MEB L.L.C me NUI : 810975576 nuk ka arritur të ofroj dëshmi për të cilat e konteston AK-Komunën e Prizrenit i cili ka paraqitur kërkesë sikurse parashihet në nenin 99 paragrafi 2 i LPP-se “ *Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje*

me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare''.

Duke u nisur nga ajo se Organi Shqyrtues i Prokurimit mund veprojë vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç përcaktohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, pas dëshmimeve të dorëzuara me kërkesë të PSH data 19.06.2025 ku ka kërkuar korespondimin në mes të AK-se dhe ATK-se, pas pranimit të e-mailit lidhur me faturën ATK ka deklaruar citoj '' *Pas analizimit të fatures dhe dokumentacionit kemi konstatuar: 1)Subjekti SFK SHPK (Dardan Export Group shpk) me numër të biznesit 810973041 e ka të deklaruar në libër të shitjes faturën nr 001/2020 të datës 15.09.2020.Raportimi i librit të shitjes është bërë me datë 07.02.2025. Ndërsa fatura nr 001/2020 e datës 15.09.2020 nuk është e deklaruar në deklarate të tvsh-se . Subjekti SFK SHPK (Dardan Export Group shpk) me numër të biznesit 810973041 për periudhën 09/2020 ka pasur kontrollë nga ana e Atk-se dhe në mungesë të informatës fatura nr 001/2020 e datës 15.09.2020 nuk është përfshirë tek qarkullimi(shitjet) **Perderisa fatura nuk është e deklaruar në deklarate të Tvsh-se e njëjta faturë konsiderohet e padeklaruar.** 2)Subjekti MEB Llc me numër të biznesit 810975576 e ka deklaruar në libër të blerjes faturën nr 001/2020 të datës 15.09.2020.Deklarimi është bërë me korrigjim të librit të blerjes me datë 07.02.2025. Fatura nr 001/2020 e datës 19.09.2020 nuk është e deklaruar si blerje tek deklarata e Tvsh-se. **Perderisa fatura nuk është e deklaruar në deklarate të Tvsh-se e njëjta faturë konsiderohet e padeklaruar.** Një element tjetër që duhet cekur është se në faturë është i evidentuar edhe një numër tjetër i biznesit nr 811978131 numër që i përket Klubi i futbollit Liria Shpk subjekt i regjistruar me datë 18.10.2022'', nga gjithë të dhënat faktet provat e pranuar nga AK –ja, Paneli Shqyrtues konstaton se AK ka arritur të ofroj dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve fatura fiktive nga ana e OE MEB L.L.C, për aktivitetin e prokurimit: Sigurimi fizik i objekteve të shëndetësisë primare në Komunën e Prizrenit, me nr: të prokurimit: 622-24-8069-2-2-1.*

Paneli shqyrtues, vlerëson se janë plotësuar kushtet për zbatim të nenit 99 paragrafit 2 të LPP-se, për marrjen e masave eventuale sipas nenit të cituar më lart, sepse veprimet e operatorit ekonomik janë në kundërshtim me nenin 99.2 të LPP-se.

Andaj, paneli shqyrtues vendos që OE ''MEB L.L.C'', NUI 810975576, të vendoset në listën e zezë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve kalendarik.

Duke ju referuar të lartëcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 99.2 të LPP, Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.